



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:293530

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05614826

P.nr.3719/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarve D. K. dhe A. B. të dytë nga F. K., të akuzuar për veprën penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 pika 1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3930/21 të datë 29.12.2021, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 05.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Eset Rama dhe të akuzuarve D. K. dhe A. B., me datë 05.04.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 24.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. D. K, i biri i A. dhe nëna N, e gjinisë M., i lindur me, në P....., me vendbanim në F.... K.... Rr. “K... i L”, me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës
2. A.B, i biri i F. dhe nëna Sh., e gjinisë M., i lindur me, në P....., me vendbanim në F. K. Rr.”H. G.” L. E., me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Sepse:

Me datë 02.08.2021 rreth orës 03:00 ne rrugën “D.” ne F. K., saktësisht ne bodrumin e lokalit “D. O.”, te pandehurit D. K. dhe A. B. ne bashkëkryerje me te miturin V.I, pas marrëveshjes paraprake, me dashje dhe me qellim qe ti shkaktojnë lëndime trupore tani te dëmtuarit V. R., lidhur me një mosmarrëveshje për shkak te xhelozisë ne mes te pandehurit D. dhe te dëmtuarit V., ashtu qe pasi i dëmtuari arrin ne bodrumin e lartcekur, te pandehurit D., A. dhe i mituri V.I., e sulmojnë te dëmtuarin, ne atë mënyre qe e godasin me shufra te plastikes ne fytyre, koke dhe pjese te ndryshme te trupit, me ç’ rast te dëmtuarit V. R. i shkaktojnë lëndime trupore, ne forme te gërvishtje lëkurore te regjionit te mollëzës se majte te fytyrës, te regjionit zverk or te kokës

dhe shpinës, ku si te tilla bëjnë pjese ne dëmtime te lehta trupore, me pasoja te përkohshme ne shëndet.

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale *Lëndim i lehtë trupor* nga neni 185 par 1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 31, 38, 39, 47, 48, 69, 70, 71, 72 KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i:

GJYKON

1. Të pandehurin D. K.

Me dënim me kusht duke i shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj paushallin gjyqësor në shumë shumën prej 20 (njëzet) Euro si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

1. Të pandehurin A. B.

Me dënim me kusht duke i shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj paushallin gjyqësor në shumë shumën prej 20 (njëzet) Euro si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari V. R. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.3930/21 të datë 29.12.2021, ndaj të akuzuarve D. K. dhe A. B. B. A. për shkak të dyshimit të bazuar mire se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale *Lëndim i lehtë trupor* nga neni 185 par 1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penalo juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 05.04.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Eset Rama dhe të pandehurve D. K. dhe A. B. ku të njëjtit u njoftuan me të drejtat e tyre, me aktakuzën dhe provat kundër tyre.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori të pandehurit u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurve dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se të pandehurit kanë pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të pandehurit janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurve D. K. dhe A. B. Qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të tyre, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarit, gjykata ka vlerësuar faktin se të njëjtit kanë treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier të përgjegjshëm për veprimet e tyre dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e kanë kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarve. Ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 48 të KPRK-se të akuzuarit i gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarve është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurve ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro për secilin të pandehur.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:293530
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05614826

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.3719/21 datë 24.04.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.